

	KONKURS PUBLIK	DT-BNJ-027
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 1 nga 3</i>
Departamenti i Burimeve Njerëzore		Sektori i Personelit

Bazuar në nenin 8 të Ligjit të punës nr. 03/L-212 të Republikës së Kosovës, nenin 4 (paragrafi 1, 2, 3, 4, 5) dhe nenin 5 të Udhëzimit Administrativ 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik si dhe pikën 4.4, 5.1.1, 6.2, 9.2 dhe 9.3 paragrafi i tretë, pika e parë të Politikës së Rekrutimit, Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut-KOSTT sh. a. rishpall:

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e pozitës së lirë të punës:

1. Drejtor i Departamentit të Operatorit të Tregut

Kushtet e përgjithshme:

Kohëzgjatja e punësimit: Për kohë të pacaktuar.

Në tekstin në vijim përdorimi i njërës gjini nuk përjashton gjininë tjetër.

Orari i punës: Puna me orar të plotë. Lartësia e pagës do të përcaktohet në harmoni me politikat e aprovuara të KOSTT-it.

Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën: Drejtor i Departamentit të Operatorit të Tregut

Nr. referues i pozitës: 1.8.0.0

Detyrat e përgjithshme

Drejtori i Departamentit të Operatorit të Tregut duhet të siguroj menaxhimin e duhur të Departamentit të Operimit të Tregut të KOSTT-it në pajtim me kërkesat ligjore, kushtet e licencës dhe praktikën më të mirë profesionale. Brenda punës së tij ai/ajo zhvillon, në bashkëpunim të ngushtë me departamentin e Operimit të Sistemit dhe në pajtim me rregullat e tregut, strategjinë operative të KOSTT-it për të arritur përsosmërinë operative. Ai/ajo gjithashtu mbikëqyrë punën e sektorëve dhe menaxherëve në kuadër të Departamentit të Operatorit të Tregut:

- Operimi i Tregut
- Barazimi Përfundimtar
- Administrimi dhe Zhvillimi i Tregut

Detyrat specifike:

Drejtori i Departamentit të Operatorit të Tregut koordinon zhvillimin e Operimit të Tregut të KOSTT-it. Ai/ajo i raporton Kryeshefit Ekzekutiv. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të tij/saj specifike në Operimin e Tregut janë:

Organizimi dhe Mbikëqyrja e Punëtorëve

- Siguron që departamenti i Operimit të Tregut funksionon në mënyrë efektive në planifikimin e operimit të sigurt të sistemit dhe në operimin e tregut balancues.
- Mbikëqyr punën e menaxherëve të sektorëve që i raportojnë atij/asaj.
- Propozon emërimin në pozitat menaxhuese në departamentin e Operimit të tregut, me kusht të miratimit nga Kryeshefi Ekzekutiv.
- Në pajtim me menaxherët që i raportojnë atij/asaj përcakton objektivat e departamentit të Operimit të Tregut.
- Siguron që niveli i punëtorëve, pajisjeve dhe sistemeve janë adekuat për të përmbushur funksionet e departamentit të Operimit të Tregut.

- Siguron që punëtorët janë kualifikuar përshtatshëm dhe të trajnuar, mirëmban një pasqyrë të nevojave për trajnime, dhe sipas nevojës organizon trajnime.

Operimi i Tregut

- Menaxhimin e procesit të nominimit të programeve kontraktuale, Operimin dhe menaxhimin e procesit të alokimit të kapaciteteve interkonektive.
- Operimin dhe menaxhimin e tregut të organizuar, në bashkërendim me Bursën e Energjisë
- Organizimi i blerjes dhe shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga BRE-të në harmoni me rregullën e skemës mbështetëse për BRE-të, operimin dhe menaxhimin e tregut balancues të energjisë elektrike ex-ante (operimi në kohë reale bëhet nga Operatori i Sistemit).

Barazimi Financiar

- Llogaritjen e nivelit të Garancionit Financiar të Palëve Tregtare.
- Llogaritjen dhe barazimin financiar të obligimeve dhe detyrimeve të palëve në treg dhe faturimi i tyre.
- Menaxhimin e procesit të Barazimit përfundimtar të të dhënave matëse interkonektive me OST-të fqinje dhe me Administratorin e Qendrës Koordinative Jug.
- Raportimi periodik për rezultatet e barazimit përfundimtar.
- Administrimi i platformave/programeve të IT-së së tregut.

Administrimi dhe Zhvillimi i Tregut

- Administrimin e Aderimit në Rregullat e Tregut të palëve aplikuese, tërheqjen dhe përjashtimin.
- Bashkëpunimi me Agjentin për Administrimin e Matjeve.
- Menaxhimin e procesit të transferit të konsumatorëve.
- Administrimi i Marrëveshjeve për Blerjen e Energjisë me Gjeneratorët BRE të pranuar në Skemën Mbështetëse, sipas Kornizës së Rregulluar dhe Furnizuesit.
- Zhvillimi dhe rifreskimi i Dizajnit të tregut dhe Rregullave të Tregut në harmoni me ndryshimet ligjore dhe zhvillimin e tregut.
- Zhvillimi dhe analiza të tregut.
- Publikimi i të dhënave dhe informatave relevante të tregut.

Të tjera

Kontribuon në aktivitetet e politikave dhe vendimmarrjes të Kryeshefit Ekzekutiv.

Kryen detyra tjera të cilat kërkohen nga Kryeshefi Ekzekutiv dhe të cilat janë të nevojshme për funksionimin efektiv të KOSTT-it.

Kualifikimet, aftësitë dhe shkathtësitë tjera për pozitën e shpallur:

Kandidatët/et përveç kushteve të përgjithshme të punësimit të cilat kërkohen me ligj, duhet ti plotësojnë edhe këto kushte të veçanta:

- Diplomë Universitare (bachelor) në fushat e Administrim Biznesi, Ekonomisë, dhe ose Inxhinierisë Elektrike
- Diplomë Master në këto fushat e lartcekura konsiderohet përparësi
- Së paku 7 vite përvojë profesionale pas diplomimit të dëshmuar në ndërmarrje ose institucione publike të madhësisë dhe kompleksitetit të ngjashëm me Operatorin e Sistemit, Transmisionit dhe Tregut.
- Së paku pesë (5) vite përvojë pune në pozita udhëheqëse në ndërmarrje ose institucione publike të madhësisë dhe kompleksitetit të ngjashëm me Operatorin e Sistemit, Transmisionit dhe Tregut.
- Njohje të avancuar të sektorit të energjisë, sektorit publik, menaxhimit financiar, parimeve të ekonomisë dhe të qeverisjes korporatave.
- Njohja e mirë e kornizës rregullative të sektorit energjetik, sektorit publik, rregullave dhe politikave përkatëse është tejet e dëshirueshme.

- Aftësi të shkëlqyeshme për udhëheqje (leadership) dhe menaxhim, punë ekipore dhe motivim të punonjësve.
- Aftësi të shkëlqyeshme analitike, aftësi për të analizuar të dhëna komplekse të tregut, trendëve, dhe indikatorëve të performancës është kyçe.
- Aftësi të mira të komunikimit dhe bashkëpunimit, aftësitë e komunikimit efektiv janë të nevojshme në të shkruar dhe në të folur qoftë siç mund të jenë ekipet e brendshme, hisedarët e jashtëm, rregullatori, pjesëmarrësit e tregut dhe palët tjera të interesit, etj.
- Aftësi të mendimit strategjik, i punësuar duhet të ketë aftësi të mendimit strategjik dhe të parashikoj të ardhmen e sektorit të energjisë. Kjo përfshinë identifikimi i trendeve dhe planeve zhvillimore afatgjate.
- Nuk është i dënuar me aktgjykim të formës së prerë për kryerjen e veprës penale të dënueshme së paku gjashtë (6) muaj
- Njoha e shkëlqyer e gjuhës shqipe në të shkruar dhe në të folur është e domosdoshme
- Njohja e shkëlqyer e gjuhës angleze në të shkruar dhe në të folur konsiderohet përparësi
- Njohja e shkëlqyer e pakos së Microsoft e në veçanti aplikacioneve të procesimit të tekstit (MS Word) dhe llogaritjeve tabelare (MS Excel).

Kushtet e punës: Puna në Zyre

Vendi/Lokacioni: Selia Qendrore e KOSTT-it

Forma e aplikimit për pozitën e shpallur:

Të interesuarit mund të aplikojnë përmes formës elektronike duke i plotësuar aplikacionet të cilat mund t'i shkarkojnë nga Web Faqja e KOSTT-it: www.kostt.com

E-mail adresa ku duhet të aplikohet është: punesimi@kostt.com

Aplikacionet do të pranohen vetëm nga kandidatët, të cilët i plotësojnë kërkesat e parashtruara si në konkursin publik të shpallur në mjetet e shkruara të informimit dhe në webfaqen zyrtare të KOSTT-it.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e diplomës së shkollimit si dhe kopjet e dëshmive tjera sipas kërkesave të konkursit.

Dokumentet origjinale të cilat i vërtetojnë faktet e theksuara në aplikacion duhet të prezantohen në momentin e intervistimit ose para intervistimit nëse kërkohen.

Selektimi i kandidatëve që plotësojnë kushtet e konkursit, testimi me shkrim, intervista, përzgjedhja dhe informimi i kandidatëve do të bëhen në përputhje me afatet dhe kriteret sipas udhëzimit administrativ për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik nr.07/2017.

Konkursi publik mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në mjetet e shkruara të informimit dhe në webfaqen e KOSTT-it, nga data 24.08.2023 deri me 07.09.2023 ora 24:00.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.

KOSTT ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës si dhe inkurajon kandidatët e gjinisë femërore, të rinjtë dhe pjesëtarët e komuniteteve që të aplikojnë për këtë pozitë pune.